



HEQJE DORË NGA PËRGJEGJËSIA: Jeni të lutur të vini re se publikimi i tekstit ligjor të mëposhtëm nuk është zyrtar dhe NUK përbën dokument zyrtar të Republikës së Shqipërisë. Konsiderohet thjesht si mjet dokumentimi dhe EURALIUS-i nuk merr asnjë përgjegjësi për përmbajtjen.

L I G J

Nr.8053, datë 21.12.1995

PER KALIMIN NE PRONESI PA SHPERBLIM TE TOKES BUJQESORE

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR I REPUBLIKES SE SHQIPERISE

V E N D O S I:

Neni 1

Ky ligj ka për qëllim rregullimin ligjor të kalimit në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore familjeve bujqësore ose individëve që e kanë atë në përdorim.

Neni 2

Përfshihen nga dhënia në pronësi:

1. Tokat bujqësore që në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji ndodhen brenda vijës kufizuese të qyteteve, fshatrave ose qendrave të banuara.
2. Tokat bujqësore të përfshira në zonat me përparësi turizmin, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.88, datë 1.3.1993 "Për miratimin e zonave që kanë përparësi turizmin". Në pikën 1 dhe 2 nuk përfshihen familjet ose individët që i kanë fituar këto toka bujqësore si bashkëthemelues të ish-kooperativave bujqësore apo të ndërmarrjeve bujqësore.
3. Tokat bujqësore të përfshira në veprimtarinë eksperimentale-shkencore të instituteve kombëtare shkencore.
4. Tokat bujqësore të dhëna në përdorim specialistëve të bujqësisë sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.452, date 17.10.1992 "Për ristrukturimin e ndërmarrjeve bujqësore", pika 5, paragrafi i dytë.
5. Tokat bujqësore që:
 - a. janë pushtuar ose fituar në mënyrë të paligjshme.

b. kanë qenë në përdorim, por që nga përdoruesit janë bërë kalime pronësie të paligjshme ose çdo lloj veprimi tjetër të pabazuar në ligj.

Veprimet për kalimin e pronësisë për rastet e përmendura në pikat "a" dhe "b", si dhe regjistrimet e këtyre kalimeve janë të pavlefshme.

6. Tokat bujqësore në përdorim të ndërmarrjeve të përbashkëta, deri në zgjidhjen e kontratës së lidhur midis palëve ose mbarimin e afatit të saj.

Neni 3

Tokat bujqësore që nuk kalojnë në pronësi private në rastet e parashikuara në nenin e mësipërm, mbeten pronë shtetërore.

Neni 3/1

(Shtuar me Ligjin Nr. 10 208, datë 23.12.2009)

1. Përdoruesit e tokave bujqësore brenda vijave kufizuese të qyteteve, fshatrave ose qendrave urbane, që disponojnë aktet e marrjes së tokës në përdorim, të lëshuara deri në fund të muajit shkurt të vitit 1996, kompensohen me truall në pronësi brenda zonës urbane përkatëse në çastin që toka e tyre do të kalojë për kompensim fizik të subjekteve të shpronësuara ose për ndërtime publike.

Kompensimi në truall bëhet si më poshtë:

- a) për familjet me dhe mbi 6 pjesëtarë, sipërfaqja e truallit është 750m²;
- b) për familjet me më pak pjesëtarë zbritet 150 m² për çdo pjesëtar më pak, në përputhje me të dhënat e regjistrit të gjendjes civile të datës 31.12.1995, por jo më pak se 300 m².

2. Përdoruesit e tokës bujqësore brenda vijave kufizuese të zonës me përparësi turizmin, të përcaktuara sipas vendimit nr. 88, datë 1.3.1993 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e zonave që kanë përparësi zhvillimin e turizmit", që disponojnë aktet e marrjes së tokës në përdorim, të lëshuara deri në fund të muajit shkurt të vitit 1996, kompensohen me truall në pronësi brenda zonës turistike përkatëse, në çastin që toka e tyre do të kalojë për kompensim fizik të subjekteve të shpronësuara ose për ndërtime publike.

Kompensimi në truall bëhet si më poshtë:

- a) për familjet me dhe mbi 6 pjesëtarë sipërfaqja e truallit është 750m²;
- b) për familjet me më pak pjesëtarë zbritet 150 m² për çdo pjesëtar më pak, në përputhje me të dhënat e regjistrit të gjendjes civile të datës 31.12.1995, por jo më pak se 300 m².

Neni 3/2*(Shtuar me Ligjin Nr. 10 208, datë 23.12.2009)**(Ndryshuar me Ligjin Nr. 56, datë 17.05.2012)*

1. Kompensimi me truall në pronësi në komunën e Ksamilit bëhet në masën e përcaktuar në nenin 3/1 të këtij ligji dhe vetëm për familjet bujqësore e për individët:

- a) që figurojnë punonjës të ish-NB Ksamil në periudhën 1.8.1991 deri 1.10.1992;
- b) që kanë ardhur në ish-NB Ksamil nga 1.8.1991 deri në 4.5.1994, subjekte të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 60, datë 21.2.1994 "Për dhënie toke në përdorim familjeve fshatare, banorë të ish-NB-së së Ksamilit", të ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 185, datë 4.5.1994, të cilat plotësojnë kushtet e pikës 2 të këtij vendimi dhe që në kohën e hyrjes në fuqi të këtij ligji figurojnë banorë në gjendjen civile të Ksamilit.

2. Subjekteve të pikës 1 të këtij neni, sipërfaqja për kompensim, sipas kriterëve të përcaktuara në nenin 3/1 të këtij ligji, u përlllogaritet si vijon:

- a) Nga totali i sipërfaqes së përlllogaritur për kompensim me truall zbritet sipërfaqja e dhënë për sheshe ndërtimi brenda kësaj zone, me vendime të miratuara nga komuna.
- b) Në totalin e sipërfaqes së përlllogaritur për kompensim me truall përfshihet edhe sipërfaqja e zënë me ndërtime pa leje, që është legalizuar nga organet kompetente, sipas dispozitave të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar. Në rastin kur subjekti ka kryer pagesën për truallin, vlera e paguar sipas mënyrës që ajo është kryer, i kthehet këtij subjekti, brenda një viti nga data që ai merr dokumentin e pronësisë për truallin, sipas dispozitave të këtij ligji.
- c) Sipërfaqet e zëna me ndërtime pa leje, të cilat janë në proces legalizimi, përfshihen brenda totalit të sipërfaqes që subjekteve u takon të marrin, sipas kriterëve të përcaktuara në nenin 3/1 të këtij ligji. Këto subjekte përjashtohen nga detyrimi për pagesën vetëm për sipërfaqen e truallit të zënë nga ndërtimet që do të legalizohen, sipas dispozitave të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar.

Neni 3/3*(Shtuar me Ligjin Nr. 10 208, datë 23.12.2009)*

1. Trojet e vëna në dispozicion për kompensim për përdoruesit e tokës bujqësore, sipas këtij ligji, përcaktohen:

- a) në zonat turistike bregdetare, nga Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, në bashkëpunim me organet e qeverisjes vendore në territorin ku ndodhet truall që kalon për kompensim;
- b) në zonat periferike të qyteteve dhe qendrave urbane, nga Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, në bashkëpunim me organet e qeverisjes

vendore në territorin ku ndodhet trualli që kalon për kompensim, pas përfundimit të procesit të legalizimit nga ALUIZNI.

2. Sipërfaqet e tokës në përdorim që lirohen nga përdoruesit, si pasojë e zbatimit të dispozitave të këtij ligji, kalohen:

a) në Agjencinë e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, si fond fizik për kompensimin e subjekteve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.868, datë 18.6.2008 "Për krijimin e fondit të kompensimit fizik nga fond i tokës bujqësore", kur këto sipërfaqe, në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, figurojnë në zërin kadastral tokë bujqësore;

b) në pronësi të shtetit dhe administrohen sipas kompetencave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për urbanistikën, kur këto sipërfaqe, në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, figurojnë në zërin kadastral tokë urbane.

3. Procedurat dhe autoriteti publik që bën kalimin në pronësi përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave."

Neni 4

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, familjet bujqësore ose individët që kanë dokumente për dhënien në përdorim të tokës bujqësore, duhet të paraqiten pranë organeve të pushtetit lokal (komunë, bashki) për plotësimin e dokumentacionit përfundimtar sipas procedurave të ligjit nr.7843, datë 13.7.1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme".

Neni 5

Aktet ligjore e nënligjore që bien në kundërshtim me këtë ligj shfuqizohen.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.1343, datë 3.1.1996 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha